HULUMTIMI I MEKANIZMAVE PËR PJESËMARRJE TË QYTETARËVE

DOKUMENT I SHKURTËR PËR POLITIKËN PUBLIKE

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Ky dokument i politikave publike është hartuar në bazë të analizës së të dhënave nga hulumtimi i mekanizmave për pjesëmarrje të qytetarëve, të realizuar në vitin 2023 dhe 2024 nga Konsulenca për Zhvillim Strategjik (KZHS) Shkup për Fondacionin për Zhvillimin e Komunitetit Lokal (FZHKL) Shtip, në kuadër të projektit "Mbështetja organizative për përforcimin e demokracisë lokale". Analiza bazohet në metodologji hulumtuese gjatësore që u krye fillimisht në vitin 2017 përmes anketës me qytetarët, intervistave me pjesëmarrës lokal dhe grupe të fokusit, duke bërë një përmbledhje të praktikave dhe perceptimeve rrjedhëse të autoriteteve lokale dhe qytetarëve në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve.

Nga analiza konstatohet qartë se ka përpjekje nga autoritetet lokale për përfshirjen e qytetarëve, veçanërisht kur bëhet fjalë për informimin lidhur me aktivitetet e tyre. Në këtë kontekst, autoritetet lokale përdorin në mënyrë aktive të gjitha mjetet e disponueshme të komunikimit, duke u mundësuar qytetarëve që të kenë njohuri të përgjithshme për aktivitetet e autoriteteve të tyre lokale.

Megjithatë, sfidat paraqiten në sferën e përfshirjes së barabartë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes. Pavarësisht mekanizmave dhe mjeteve ekzistuese të paraqitura në kornizë ligjore, ato shpesh perceptohen si të ndërlikuara dhe të detyrueshme për t'u zbatuar me kritere minimale, që kufizon përdorimin e tyre nga qytetarët dhe çon në përdorim selektiv nga autoritetet vendore.

Qytetarët shprehin preferencën sa i përket kontaktit të drejtpërdrejtë me vendimmarrësit, një qasje që autoritetet lokale e konsiderojnë gjithashtu si më efektive. Si rezultat i kësaj, format e konsultimit të drejtpërdrejtë si tubimet e qytetarëve dhe takimet ballë për ballë janë metodat më të zakonshme të përfshirjes.

Interesat e qytetarëve fokusohen mbi temat kyçe si buxheti, planet urbanistike dhe investimet kapitale, por duket se konsultimet shpeshherë janë sipërfaqësore dhe shërbejnë më shumë si formalitet. Organizatat e qytetarëve theksojnë se autoritetet përfshijnë kryesisht qytetarët kur ata përfitojnë drejtpërdrejt nga kjo.

Gjithashtu, vërehet nivel i ulët i aktivitetit të qytetarëve në afrimin e qeverisjes lokale të tyre, që tregon nevojën e përmirësimit të qasjeve dhe mekanizmave për pjesëmarrjen e qytetarëve, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit dhe motivimit të qytetarëve për pjesëmarrje.

Edhe pse ekziston baza ligjore dhe vullneti për pjesëmarrjen e qytetarëve, nevojiten përpjekje dhe përmirësime shtesë për zbatimin efektiv dhe përfshirjen e vërtetë të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal. Kjo analizë ofron një sërë rekomandimesh për autoritetet lokale, qytetarët dhe palët e tjera të interesuara për përmirësimin e proceseve të pjesëmarrjes së qytetarëve në nivel komunal, me qëllim përfundimtar të arritjes së transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit më të madh në qeverisjen lokale.

Pandemia KOVID-19 ka pasur ndikim të rëndësishëm mbi mekanizmat dhe mundësitë për pjesëmarrjen e qytetarëve, duke synuar format më digjitale të pjesëmarrjes. Transformimi i tillë paraqet edhe sfidë edhe mundësi për komunat që t'i përshtatin dhe përmirësojnë strategjitë e tyre lidhur me përfshirjen e qytetarëve.

REKOMANDIME MUNDËSI PËR PËRMIRËSIM

Gatishmëria e ulët e komunave për përfshirjen e qytetarëve, qytetarët kanë dhënë notën mesatare prej 2.34 në shkallën deri në 5, për gatishmërinë e komunave për t'i përfshirë në proceset e vendimmarrjes, që tregon gatishmëri dhe aktivitet të pamjaftueshëm të komunave në këtë aspekt.

Përfshirja e kufizuar përmes komunikimit të drejtpërdrejtë, përqindje e madhe e të anketuarve kanë deklaruar se nuk janë të përfshirë në proceset e vendimmarrjes ose se komuna nuk i kontakton për të ndarë mendimin e tyre.

Nevoja për përmirësimin e metodave të përfshirjes, edhe pse ekzistojnë metoda të ndryshme të përfshirjes si tribunat publike, mediat sociale dhe anketat, rezultatet tregojnë se ka nevojë për përmirësimin e metodave në mënyrë që ato të zbatohen më lehtë.

Praktika ekzistuese e përfshirjes, edhe pse komunat kanë metoda të ndryshme për përfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes, mungesa e konsistencës dhe efektivitetit në zbatimin e tyre është veçanërisht e theksuar. Qytetarët shpesh mendojnë se nuk janë të informuar apo të përfshirë në mënyrë të mjaftueshme në vendimmarrjet kritike.

Interesat dhe prioritetet e qytetarëve, ekziston interes i qartë i qytetarëve për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes, që i referohet zhvillimit komunal dhe urban, mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe politikave sociale dhe rinore. Kjo tregon nevojën për fokus më të madh mbi këto fusha gjatë planifikimit të aktiviteteve konsultative.

Mosinteresim i konsiderueshëm për pjesëmarrje, përqindje e lartë e qytetarëve kanë treguar mosinteresim ose mungesë pjesëmarrjeje në proceset e vendimmarrjes në nivel komunal. Kjo tregon nevojën për përfshirje dhe aktivizim më të mirë të qytetarëve në proceset demokratike.

Arsyet për mosinteresim, arsyet më të zakonshme të mosinteresimit përfshijnë mungesën e kohës, burimeve ose besimit se mendimi i tyre nuk do të merret parasysh. Gjithashtu, një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve kanë deklaruar se nuk ndihen mjaft të informuar apo të ftuar për të marrë pjesë.

Forumet në komunitet, anketat dhe tribunat publike janë metodat më të njohura të pjesëmarrjes, që tregojnë vlerën e lartë të komunikimit dhe ndërveprimit të drejtpërdrejtë midis qytetarëve dhe vendimmarrësve.

Qytetarët konsiderojnë se anketat janë instrument i rëndësishëm për të shprehur opinionet dhe prioritetet e tyre, që tregon nevojën komunat t'i përdorin anketat si mekanizëm standard për konsultimin e qytetarëve.

Ka potencial për përmirësimin e platformave të internetit për pjesëmarrje, si forumet e internetit dhe mediat sociale, të cilat mund të rrisin mundësitë e pjesëmarrjes për një gamë të gjerë qytetarësh.

Potenciali për efekt pozitiv nga pjesëmarrja thelbësore, shumica e të anketuarve konsiderojnë se përfshirja thelbësore e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes ka potencial të shkaktojë efekt pozitiv. Kjo tregon se qytetarët besojnë se pjesëmarrja e tyre më domethënëse mund të kontribuojë në vendime më të mira dhe ndryshime pozitive në komunitetin e tyre.

Pjesëmarrja e qytetarëve konsiderohet e rëndësishme për qeverisjen lokale - Shumica e qytetarëve e konsiderojnë pjesëmarrjen e qytetarëve si kontribut pozitiv në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal, që tregon një vlerë të lartë që qytetarët i kushtojnë pjesëmarrjes së tyre.

Ekziston nevoja rritjen e efikasitetit dhe dukshmërisë së përfshirjes së qytetarëve - megjithëse shumica e qytetarëve konsiderojnë se pjesëmarrja e tyre ka potencial për efekt pozitiv, ka ende nevojë për përmirësimin e mekanizmave të përfshirjes, mne qëllim të rritjes së efikasitetit dhe dukshmërisë prej kontributeve të tyre.

Ky projekt financohet nga Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedonia.

"Përmbajtja është përgjegjësia e vetme e autorëve dhe Fondacionit për Zhvillim të Komunitetit Lokal - Shtip dhe në asnjë mënyrë tjetër nuk mund të konsiderohet se i reflekton pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit Shoqëria e Hapur - Maqedonia".

FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN ОТВОРЕНО
SOCIETY ОПШТЕСТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

ФОНДАЦИЈА ЗА РАЗВОЈ НА ЛОКАЛНАТА ЗАЕДНИЦА
LOCAL COMMUNITY DEVELOPMENT FOUNDATION